

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“RIKONSTRUKSION I SHKOLLËS 9 -VJEÇARE ÇUKË”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45214220-8 Punime ndërtimi për shkolla 8-9 vjeçare

VLERA E FONDIT LIMIT:

24 030 000 (njëzet e kater milion e tridhjetë mijë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Sarandë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur/ fondit limit të kontratës. Kriteri konsiderohet

i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) **totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;** ii) **shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;** iii) **ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël**”.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. 2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve

Pika 2.3.1 germa “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjessë tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 germa “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin erregullave te prokurimit publik” te ndryshuar).

Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Referuar fondit limit sipas nenin 39 pika 5, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- NP - 3 A Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
- NP-7 A. Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

- NS-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
- NS-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
- NS-12 A Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.
- NS-14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorezoje liçencat profesionale sipas zërave të preventivit që në baze të marrëveshjes së bashkepunimit merr përsiper të realizojë. Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për liçencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me liçencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane” si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.1 ku përcaktohet se: çdo subjekt juridik i liçencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi, vetëm në klasat dhe kategoritë e punimeve, që ka përcaktuar në liçencë. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë subjekti juridik për të fituar klasa e kategori në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përcaktohen në rregulloren për dhënien e licensave profesionale, që miraton Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.

N.P. 3 - Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada

Me punime të tilla, referuar VKM nr.42 të datës 16.01.2008 konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit

NP-7 a. Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje

Me punime të tilla, referuar VKM nr.42 të datës 16.01.2008 konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të

nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura. Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.S-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve

Me punime të tilla, sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar *konsideron çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.*

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime prishje te ndërtimeve te terrenit ekzistues. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.S-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar me punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese *konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.*

Vendosja e këtij kriteri u referohet punimeve të parashikuara në projektet teknike, relacionet teknike, specifikimet, preventivin dhe grafikun e punimeve për zbatimin e veprës. Këto punime parqiten të detajuara në projektin arkitekturor dhe specifikimet e punimeve ndërtimore. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

NS-12 A Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi. Vendosja e këtij kriteri u referohet punimeve të parashikuara në projektet teknike, relacionet teknike, specifikimet, preventivin dhe grafikun e punimeve për zbatimin e veprës. Këto punime parqiten të detajuara në projektin arkitekturor dhe specifikimet e punimeve ndërtimore. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.S- 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV

Me punime të tilla, sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me

to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per periudhen mujin e fundit nga data e hapjes se ofertave si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi	1 (një)
- Inxhinier Elektrik	1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik	1 (një)

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diplomë, Kontratë pune, CV, Librezë Pune

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikës 1, dhe të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “ Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të 21 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”.

Autoriteti/enti kontraktor duhet t’i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve , është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur

një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:

Inxhinier ndërtimi :Projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon një sasi dhe tipologji të madhe të punimeve të përgjithshme ndërtimore, të tilla si punimet e prishjes, punimet e gërmimit, punimet e shtresave, punimet e muraturës, suvatimet, hidroizolimet, sistemimet e jeshtme etj. Punimet ndërtimore përbëjnë pjesën më të madhe të vëllimit të punëve për zbatimin e projektit, sikurse edhe ato më komplekset. Punimet e ndërtimit duhet të përmbushin kushtet teknike të zbatimit.

Inxhinieri i Ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit si dhe për sigurimin teknik në proceset e punës. Ky inxhinier ka për qëllim menaxhimin e zbatimit të punimeve ndërtimore, analizimin e projektit pasi kemi të bëjmë me punime ndërtimi apo rikonstruksioni, ndjekjen e ecurisë së punimeve në kantier;

- **Inxhinier elektrike**. Punimet elektrike përfshijnë zëra me vlera të konsiderueshme në prevetivin total të punimeve. Zërat e përfshirë në preventiv shoqërohen me zgjidhet teknike të hartuara nga eksperti inxhinier elektrik në projekt, në relacionin teknik dhe specifikimet teknike. Të tilla punime janë punimet për kuadrot elektrike, sistemin e fuqisë dhe ndriçimit, sistemi i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike dhe tokëzimi, tokëzimi i përsëritur te kuadri kryesor i godinës.

Për këtë arsye, lind nevoja që për zbatimin e punimeve në të gjitha vëllimet e objektit të angazhohen minimalisht 1 (një) inxhinier elektrike të licensuar nga të cilat minimalisht një duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë.

- **Inxhinier hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidraulike, pasi referuar projektit dhe preventivit të punimeve të zbatimit, do të kryhen instalime hidraulike, të cilat kërkojnë detyrimisht mbikqyrjen nga inxhinieri hidraulik gjatë periudhës të zbatimit të punimeve.

2.3.4 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës, si më poshtë:

- 1 (një) person, i çertifikuar si Specialist për testimin e performances së materialeve / produkteve të ndërtimit / Inxhinier materialeve;

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punojësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, CV si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën mujin e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikës 1, dhe të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si

provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “ Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të 21 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”.

Autoriteti/enti kontraktor duhet t’i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njëhësuar me origjinalin.

Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Në kërkesat për personelin e kualifikuar janë kërkuar ekspertët arkitektë dhe inxhinierë të licensuar, sipas profileve të domosdoshme për të mbuluar të gjitha punimet e parashikuara në projekt – zbatimin e parashikuar të relizohet nëpërmjet kësaj kontrate. Një pjesë e këtyre ekspertëve duhet të jenë të përfshirë në licensën e shoqërisë, ndërsa pjesa tjetër jo domosdoshmerisht të përfshirë në licensën e shoqërisë, por me kontrate pune/kontrate bashkepunimi.

Specialist për testimin e performances së materialeve / produkteve të ndërtimit / Inxhinier materialesh është përgjegjës për vlerësimin dhe testimin e materialeve dhe produkteve që përdoren në industrinë e ndërtimit për t’u siguruar që ato përmbushin standardet e kërkuara për sigurinë dhe cilësinë. Ky lloj specialisti duhet të ketë njohuri të thella në lidhje me metodat e testimit, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe materialet që përdoren në ndërtim

2.3.5.a Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore , si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit , si më poshtë:

Teknik Ndërtimi	1(një)
Teknik Mekanik	1 (nje)
Teknik Elektronik	1 (nje)
Elektracist	1 (nje)
Specialist Sistemi e Vezhgimi dhe Alaramit	1 (nje)
Hidraulik	1 (nje)
Punonjes Gipsi	1 (nje)
Marangoz	1 (nje)
Bojaxhi	1 (nje)
Murator – Suvatues	1 (nje)
Kondicionimi	1 (nje)

Dur Alumini	1 (nje)
Pllakastrues	1 (nje)
Specialist IT	1 (nje)
Hidroizolues	1 (nje)
Betonues	1 (nje)

të vertetuar me diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente, kontratë pune të vlefshme, si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë .

Për punonjësit me profesionet si më sipër cituar, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit, operatorët ekonomik ofertues duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomës/certifikatës së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetërore.

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzës/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
etj					

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punojësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikës 1, dhe të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “ Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të 21 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”.

Autoriteti/enti kontraktor duhet t’i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Teknik ndërtimi është i nevojshëm për ndjekjen e realizimin e punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivave të punimeve.

Teknik mekanik është i nevojshëm për ndjekjen e realizimin e punimeve HVAC, sipas zërave të preventivave të punimeve.

Teknik elektronik është i nevojshëm për ndjekjen e realizimin e punimit të instalimit të kamerave alarme, sipas zërave të preventivave të punimeve.

Elektricitet është përgjegjës për zbatimin e punimeve elektrike, të tilla si punimet për kuadrot elektrike, sistemin e fuqisë dhe ndriçimit, sistemi i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike dhe tokëzimi, punimet për montimin e linjave elektrike, si dhe punimet për lidhjen e rrjeteve me infrastrukturën publike. Punimet elektrike zënë një vend të rëndësishëm në preventivin total të punimeve, si nga pikëpamja e sasisë, ashtu edhe të vlerave.

Specialist Sistemi e Vezhimi dhe Alaramit është përgjegjës për instalimin e kamerave CCTV, instalim alarmesh zjarrit

Hidraulik është i nevojshëm për realizimin e punimeve hidraulike sipas zërave të punimeve në perputhje me projektin dhe preventivin.

Punonjes Gipsi është i nevojshëm për realizimin e punimeve të gipsit sipas zërave të punimeve në perputhje me projektin dhe preventivin.

Marangoz është i nevojshëm për realizimin e punimeve të montimit të dyerve sipas zërave të punimeve në perputhje me projektin dhe preventivin

Bojaxhi është i nevojshëm për realizimin e punimeve bojatisjes sipas zërave të punimeve në perputhje me projektin dhe preventivin

Karpentieri është i nevojshëm për përgatitjen e kallëpeve të betonit dhe skelerive sipas zërave të punimeve ndërtimore, në perputhje me projektin dhe preventivin. Punimet e betonit dhe b/a të parashikuara në projektin konstruktiv, specifikimet teknike, preventivin dhe grafikun e punimeve lidhen ngushtë me proceset e derdhjes së betonit, pjesë e të cilave është edhe përgatitja e kallëpeve Karpentierët. Realizojnë punime të tilla si kryerjen e matjeve dhe prerjeve sipas përmasave të përcaktuara në projekt, bëjnë piketimin dhe armaturën anësore të themelit, bëjnë vendosjen e modinave për kolonat dhe muret e betonit sipas projektit, ndërtojnë armaturën, kallëpet e kolonave, mureve, shkallëve, , etj.

Murator dhe Suvatues Punimet e muraturës në objektin që ndërtohet parashikojnë ndërtimin e të gjithë themeleve, mureve dhe suvatimet, përzgjedhin materialet e nevojshme dhe veglat e punës para fillimit të procesit të punës, respektojnë me rigorozitet radhën e kryerjes së çdo procesi pune sipas orientimit të dhënë në objekt, bëjnë përgatitjen e sasisë së nevojshme të llaçit për procesin ditor të punës, duke respektuar porcionet e

duhura të materialeve përbërëse, bëjnë breza përforcues betoni në gjysmën e lartësisë së murit ose sipas specifikimit në projekt, , bëjnë stukime apo riparimet e duhura të objekteve të ndryshme, bëjnë kontrollin përfundimtar të punimeve, duke u siguruar që gjithçka është sipas përshkrimit në projekt etj.

Kondicionimi është i nevojshëm për instalimin e kondicionimit sipas zerave të punimeve në përputhje me projektin dhe preventivin .

Dur Alumini është i nevojshëm për montimin e duro alumineve sipas zerave të preventivit.

Pllakashtrues Punimet e parashikuara në këtë projekt parashikojnë shtrimin e sipërfaqeve të terreneve me pllaka etj. Këto punime në preventiv pëfshijnë sipërfaqe të mëdha.

Specialist IT është i nevojshëm për instalimin dhe konfigurimin e rrjeteve .

Hidroizolues është i nevojshëm për punimet e hidroizolimit.

Betonuesi është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të betonimit në objekt, sipas zerave të punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin.

2.3.5.b Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, / ose dhe me kontratë Bashkëpunimi si më poshtë :

- Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1(nje) me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"). si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave
- AK argumenton se kërkesa për *Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*", sipas të cilit: „*Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....*“.
- Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të

cënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.5.c Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht :

1 (një) shofer kamioni.

Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse. (Manovratorët mund të disponohen së bashku me mjetet përkatëse nëse merren me qira).

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B , operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit eskavatoriste, automakinist dhe shofere, emer/mbiemer, profil i punës, numri dhe datën e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerisë së dëshmitë së aftësisë profesionale.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punonjesit e mesipër, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atëherë manovratorët, automakinistët dhe shoferët nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Për manovrimin e makinerive mbi bazë automjeti, është kërkuar 1 (një) punonjës manovrator i mjeteve të rënda. Gjithashtu për përdorimin e kamionave/ kamioncinave është kërkuar 1 (një) shofer. Kjo kërkesë mbështetet në kategorizimet e përcaktuara në Urdhërin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikës 1, dhe të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “ Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të 21 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”.

Autoriteti/enti kontraktor duhet t'i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëhësuar me origjinalin.

Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 25 (njëzet e pesë) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Vërtetuar me:

a. Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën muajin e fundit.

b. Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën muajin e fundit, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikës 1, dhe të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “ Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të 21 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”.

Autoriteti/enti kontraktor duhet t'i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëhësuar me origjinalin.

Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialistë të fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje minimumi 1 (një) muaj nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shpangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 25 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në këto elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). (Ndryshuar me Vendimin 216, datë 13.04.2023).

Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës nga 8-10 ton me Vinc	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Kamionçine (kapaciteti mbajtës 1.5 deri në 2 ton)	1 copë	Në pronësi ose me qera
	AutoBetoniere 2.5-3.5 m ³ mjet teknologjik me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Dumper (mjet teknologjik me goma)	1 cope	Pronesi ose me qera
	Matrapik	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Moto gjenerator	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Depozite uji	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Pompe Suvatimi	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Prerëse Pllakash	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Pompë lyeje	1 copë	Në pronësi ose me qera

- a.) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm);
- b.) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë ecila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm);

- c.) Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).
- d.) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsakur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes;
- e.) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto tëqarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme nënje foto te vetme mjeti dhe targa e tij;
- f.) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjetevedhe pajisjeve të deklaruar në 2.3.7. në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor;
- g.) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar sipas pikës 2.3.7 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor ;
- h.) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesiose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor;

Disponimi i mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikës 1, dhe të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “ Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të 21 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”.

Autoriteti/enti kontraktor duhet t’i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëhësuar me origjinalin.

Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira / kontrate furnizimki janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.4. Kritere të veçanta:

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura të autorizuar/akredituara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë:

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

* Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. *Janë të vlefshme edhe çertifikimet e lëshuara nga organi i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga Republika e Shqipërisë, të njohura dhe lëshuara sipas Standardeve shqiptare të Drejtorisë së përgjithshme të Standardeve.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië. Kjo çertifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pranohet edhe ekuivalentja e saj dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Neni 79 i Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikon se autoriteti kontraktor mund të kërkojë çertifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Neni 44, pika 1 dhe pika 3 i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, përcakton se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar për çdo zë pune.

Grafiku i punimeve dhe afati përcaktuar janë pjesë e dokumentacionit të tenderit të hartuar dhe kontrolluar nga struktura teknike e posaçme.

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

2.4.3 Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë kontratë midis paleve /autorizim për materialet si me poshtë:

- a) Elektrike
- b) Hidraulike
- c) Sistemin e Kondicionimit
- d) Materialet për Izolim

2.4.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributor i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi noteriale të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave nënshkruar jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

Katalogun /et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit /ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen

Argumentimi: Paraqitja e këtyre dokumenteve është vlerësuar nga Njësia e Prokurimit pasi duke qenë se në objektin e prokurimit kemi të bëjmë me blerjen e materialeve dhe pajisjeve që do të vendosen në punimet objekt kontrate, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar , duhet që këto materiale e pajisje të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: *Autorizim prodhuesi ose distributorin, katalogët ose pjesë të tyre, dëshmitë e testimeve të kryera*, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

2.4.5 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “ Grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte dhe dhera si mbetje të parrezikshme ” ,konkretisht kodet: 01 04 08 , 17 01 01, 17 05 04, 17 05 06, 17 05 08, 17 09 04 , 20 03 06 . Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, date 11.05.2009 “Per disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat,autorizimetdhe lejet në Republikën e Shqipërisë”)Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

Argumentimi: Kriteri për licensat e mesipërme është vendosur në referencë të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”i ndryshuar , Aneksi 1 i VKM Nr. 538, datë 26.05.2009 “Për Licencat Dhe Lejet Që Trajtohen Nga Apo Njëpërmjet Qendrës Kombëtare Të

Licencimit (QKL) Dhe Disa Rregullime Të Tjera Nënligjore Të Përbashkëta”, veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme. Autoriteti kontraktor në vendosjen e këtij kriteri ka patur parasysh trajtimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta që do të dalin gjatë punimeve për të cilën janë të domosdoshme.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar nga një strukturë e posaçme e ngritur/ kontraktuar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike, termat e references, raporti teknik, preventivi me zerat e punimeve janë pjese DST.

Njesia e Prokurimit